



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE

Numri i lëndës: 2022:272596
Datë: 28.05.2024
Numri i dokumentit: 05746084

A.nr.2928-2022

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË, Departamenti për Çështje Administrative, me gjyqtaren Luljeta Maxhuni në konfliktin administrativ sipas padisë të paditësit, N.K. nga ..., të cilin e përfaqëson bashkëshortja ... me adresën ..., kundër të paditurës, Ministria e Financave Punës dhe Transfereve-Departamenti i Pensioneve për shkak të “anulimit të vendimit”, në shqyrtimin kryesor publik, të mbajtur në prani të përfaqësueses të palës paditëse dhe në mungesë të palës së paditur, me datë 28.05.2024, merr këtë:

A K T G J Y K I M

I. Aprovohet si e bazuar kërkesëpadia e paditësit, ... nga

.

II. Anulohet vendimi i datës 16.09.2022, me numër te ankesës 12043, i të paditurës, Ministria e Financave Punës dhe Transfereve-Departamenti i Pensioneve të Republikës së Kosovës në Prishtinë, dhe çështja kthehet në rishqyrtim dhe rivendosje tek e paditura.

III. Obligohet e paditura MPF/DP, të veprojë nga pikëpamja juridike e kësaj gjykate si dhe nga vërejtjet e dhëna lidhur me procedurën.

A r s y e t i m

Shqyrtimi kryesor në këtë çështje juridike është mbajtur në kuptim të nenit 41 të LKA-së, në prani të përfaqësueses të paditësit dhe në mungesë të palës së paditur e ftuar në mënyrë të rregullt gjyqësore (Provë: flet-kthesa e datës 14.05.2024) .

Paditësi me datë 20.12.2022 ka parashtruar padi në këtë gjykatë duke kërkuar nga gjykata që të miraton si e bazuar padinë për anulimin e vendimit e të paditurës si të pa bazuar si dhe kërkon ti ndër njohjen

e te drejtës në pension Paraplegjik dhe Tetraplegjik në kategorinë e parë dhe ti bëhet pagesa retroaktive e kompensimit nga dita e kërkesës.

Përfaqësuesja e paditësit në seancën e shqyrtimit kryesor ka kërkuar nga gjykata që të që të aprovohet kërkesëpatria tij dhe të anulohet vendimi kontestues i të paditurës dates 16.09.2022, si i pabazuar në ligj. E njoftoj gjykatën që e paditura me vendimin e shkalles se parë ja ka njohur të drejtën në kategorinë në shkallen e dytë, ndërsa ne shqyrtimin e ankesave është refuzuar kompensimi për personat paraplegjik dhe tetraplegjik në grupin e parë, andaj kërkoj nga gjykata që paditësi ti njihet e drejta për personat paraplegjik dhe tetraplegjik në grupin e parë pasi që i njëjti i plotëson të gjitha kushtet ligjore. Në fund thekson se, kërkon nga gjykata që të vendos në bazë të shkresave të lëndës dhe nuk kërkon ndonjë provë tjetër – ekspertizës mjekësore. Po ashtu e njoftoj gjykatën që paditësi e gëzon te drejtën e pensionit kontribut pagues të moshës, me përgatitje shkollore të mesme.

E paditura në përgjigjen në padi të datës 17.05.2024, e konteston në tërësi kërkesëpadinë e paditësit si të pabazuar duke theksuar se aktvendimi i atakuar është marrë konform të gjitha dispozitave në fuqi dhe ajo në të cilën pretendon pala se ky vendim është marrë me shkelje ligjore nuk qëndron fare, me arsyetimin se vendimi i atakuar është marrë konform legjislacionit në fuqi dhe në mënyrë të drejtë ndërsa pala paditëse pretendimet e veta nuk i ka vërtetuar as edhe me një provë të vetme. Andaj, duke u bazuar në thëniet e cekura më lartë, i propozon gjykatës që pas administrimit të provave të marr aktgjykim për refuzimin e kërkesëpadiisë së paditësit në tërësi si të pabazuar, duke lënë në fuqi vendimin e të paditurës.

Me qëllim të vërtetimit të drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike, gjykata në procedurën e provave të shqyrtimit kryesor-publik të datës 28. 05.2024, ka administruar provat relevante dhe atë: vendimi i datës 15.04.2022; vendimi i datës .16.09.2022; deklarata e datës 25.01.2022; raporti konzular i nënshkruar nga mjeket e SHSKUK; ekstrakti nga regjistri qendror i datës .26.01.2022; ekstrakti nga regjistri për ... i datës 26.01.2022; raporti nga konsulta e datës 31.12.2021; raporti nga konsulta e datës 16.12.2022; komisioni vlerësues-konstatimi i datës 04.03.2022; shqyrtimi i ankesa i datës 09.09.2022; raporti konzuloir i datës .26.01.2022; deklarata e datës 25.01.2022.

Duke vlerësuar ligjshmërinë e vendimit kontestuese komfor Nenit 44 të Ligjit për Konfliktet Administrative (LKA) – Ligji Nr. 03/L-202, gjykata pas administrimit të provave, ka gjetur se kërkesëpatria e paditësit është e bazuar.

Me vendimin e të paditurës të datës 15.04.2022, me numër 12043, gjykata vërejt se paditësit i është aprovuar kërkesa në kompensim për personat Paraplegjik dhe Tetraplegjik kategorinë e dytë per tre vite nga data 26.0.202, shumen mujore prej 150 euro, në kuptim të nenit 3 dhe 7 te Ligjit 05/L-067.

Më pas, pala paditëse i adresohet “Këshillit të Ankesave” në kuadër të DP-ve, përmes Zyrës Rajonale të Pensioneve, dhe ushtron të drejtën në ankesë brenda afatit ligjor për shkak të vërtetimit të gabuar të gjendjes faktike, shkeljeve esenciale të dispozitave Procedurale dhe Aplikim të gabuar të drejtës materiale. E paditura në fjalë, me vendimin e datës 16.09.2022, të goditur me padi, refuzon ankesën e ankueses, në këtë rast paditësit ..., për kompensim për personat Paraplegjik dhe Tetraplegjik, me arsyetimin se ankuesi, në këtë rast paditësi nuk i plotëson kushtet ligjore për t’iu njohur e drejta në kompensim për personat Paraplegjik dhe Tetraplegjik në kategorinë e parë.

Nga vendimet kontestuar del se ato përmbajnë të meta të tilla për shkak të cilave nuk mund shqyrtohet ligjshmëria e tyre. Të metat e tilla qëndrojnë në shkeljet thelbësore të dispozitave të Ligjit për Procedurën Administrative. Shkeljet thelbësore të këtyre dispozitave konsistojnë në faktin se me nenin 47 të këtij ligji është paraparë se akti administrativ, që në këtë rast nënkupton vendimet e goditura me padi, duhet të përmbajë përveç tjerash edhe një përmbledhje të konstatimeve faktike, bazuar në provat e paraqitura gjatë procedimit administrativ ose në faktet e siguruar nga administrata, një deklaram të bazës ligjore në të cilat bazohet akti etj. Akti administrativ duhet të jetë i arsyetuar. Në nenin 48 të po të njëjtit ligji, parashikohet se përveç rasteve ku ligji vet e parashikon dhënien e arsyeve, duhet të jepen domosdoshmërisht arsyet për të gjitha ato akte, të cilat pjesërisht ose tërësisht mohojnë, shuajnë, kufizojnë apo prekin në një mënyrë apo tjetër të drejtat dhe interesat ligjore ose vendosin detyrime apo ndëshkime, përbëjnë një vendim të kundërt me pretendimet e palëve të interesuara, ose janë në kundërshtim me një informacion apo propozim zyrtar etj. Arsyetimet duhet të formulohen qartë dhe të përfshijnë shpjegimet e bazës ligjore dhe faktike të aktit.

Aktvendimi i kundërshtuar është juridikisht i paqartë dhe kundërthënës me vetveten dhe me arsyetimin e tij. Në arsyetimin e tij nuk janë dhënë arsye mbi faktet vendimtare që kanë kushtëzuar marrjen e vendimit të kundërshtuar. Në arsyetimin e vendimit është dhënë një formulim i përgjithshëm dhe abstrakt ku thuhet se “ Pas shqyrtimit të ankesës dhe shkresave në lëndë, , është vërtetuar që ankesa e juaja nuk është në harmoni me pikën 1 të nenit 8, të Ligjit nr. 05/L-067. Bazuar në vlerësimin e Komisionit Mjekësor të datës 09.09.2022, nga mjekë specialist të lëmisë përkatëse, i cili e ka bërë ekzaminimin e dokumentacionit mjekësor të bashkëngjitur në ankesë dhe ka konstatuar që nuk janë plotësuar kushtet ligjore për kompensim për persona Paraplegjik dhe Tetraplegjik, prandaj ankesën e refuzon si të pabazuar.”

Gjykata për të vlerësuar ligjshmërinë e vendimit të goditur me padi, i’u referua Ligjit 05/L-067 për Statusin dhe të Drejtat e Personave Paraplegjik dhe Tetraplegjik, përkatësisht nenit 1 me të cilin është përcaktuar që “Me këtë ligj rregullohet statusi dhe të drejtat e personave, të cilët si shkak i sëmundjes apo dëmtimit kanë humbur në formë të përhershme mundësinë e zhvendosjes dhe lëvizjes së ekstremiteteve të poshtme apo personave të cilët si shkak i sëmundjes apo dëmtimit kanë humbur në formë të përhershme

mundësinë e zhvendosjes dhe lëvizjes të ekstremiteteve të sipërme dhe të poshtme të cilët marrin kompensim mujor”, ndërsa neni 3 paragrafi 1, nën par. 1.1. , me të cilin është përcaktuar që “Paraplegjikët – janë personat të cilët si shkak i sëmundjes apo dëmtimit të sistemit nervor qendror apo periferik kanë humbur në formë të përhershme mundësinë e zhvendosjes dhe lëvizjes së ekstremiteteve të poshtme”, ndërsa me nenin 8 paragrafi 1 të po të njëjtit ligj është përcaktuar që “Përfituesve të këtij ligji u njihet e drejta për një kujdestar personal, në bazë të vlerësimit nga komisioni vlerësues, me qëllim të ofrimit të kujdesit dhe shërbimeve të domosdoshme ditore, e të cilët kompensohen në shumën e njëjtë sikurse përfituesit e këtij ligji”.

Në rastin konkret gjykata gjeti se e paditura në arsyetimin e vendimit të atakuar nuk ka dhënë arsye të mjaftueshme, nuk ka administruar asnjë provë nga e cila mund të vërtetohej fakti se paditësi nuk i plotëson kriteret e parapara ligjorë për të fituar statusin e personave Paraplegjik dhe Tetraplegjik, por vetëm ka dhënë një arsyetim të përgjithësuar duke u thirrur në nenin 8 pika 1 të Ligjit me numër 05/L-067 për Statusin e Personave Paraplegjik dhe Tetraplegjik,.

Duke u bazuar nga vendimet e mëhershme, paditësja ka qenë përfituese e kompensimit për personat paraplegjik dhe tetraplegjik në kategorinë e dytë dhe në procedurë të rivlerësimit, Komisioni Mjekësor i përbërë nga mjekët specialist të lëmvive përkatëse me datë 09.09.2022, ka shqyrtuar përsëri shkresat e lëndës lidhur me gjendjen shëndetësore të paditëses dhe ka konstatuar që janë plotësuar kushtet ligjore për të drejtës në kompensim për personat paraplegjik dhe tetraplegjik të grupit të parë, megjithatë nuk e ka vlerësuar saktë faktin se a i plotëson paditësi kushtet për njohjen së të drejtës në kompensim për personat Paraplegjik dhe Tetraplegjik të grupit të parë, e që kjo e drejtë e këtij kompensimi ju është njohur me vendimin e datës 15.04.2022, për periudhën kohore prej 3 viteve- në grupin e dytë.

Andaj, Gjykata si rregull, konfliktin administrativ e vendosë në bazë të gjendjes faktike, të vërtetuar nga ana e organeve administrative, ndërsa nga aktvendimi i goditur në padi nuk mund të kuptohet se si është vërtetuar gjendja faktike. Andaj, çështja nuk është vlerësuar në mënyrë të drejtë dhe të plotë në organin e shkallës së dytë, me aktvendimin i të cilit është refuzuar ankesa e paditëses për njohjen e kësaj të drejte në grupin e parë për personat paraplegjik dhe tetraplegjik.

Të metat e cekura më lartë janë të atilla që e pengojnë vlerësimin e ligjshmërisë së aktvendimit të kundërshtuar dhe në këtë drejtim gjykata e obligon organin e paditur që në afat prej 30 ditësh, në ri procedurë të veproj sipas vërejtjeve të dhëna në këtë aktgjykim dhe pasi t’i mënjanoj të metat e cekura, të marr aktvendim të drejtë të bazuar në ligj.

Duke u bazuar në të dhënat e lart cekura, gjykata në kuptim të nenit 43, 46.2, lidhur me nenet 5, 6 dhe 38 të LKA-së, ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË
DEPARTAMENTI PËR ÇËSHTJE ADMINISTRATIVE
A.nr.2928/2022, datë 28.05.2024

G j y q t a r e
Luljeta Maxhuni

Këshillë Juridike: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa, në afat prej 15 ditësh, nga dita e marrjes së të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, përmes kësaj Gjykate.